




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

NJOFTIM MBI PËRDORIMIN E TË DHËNAVE TË HAPURA

Në mbështetje të *Ligjit nr. 33, datë 31.03.2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”*, si dhe *Udhëzimit të përbashkët nr. 2, datë 06.02.2025*, ju sqarojmë se, edhe pse aktualisht të dhënat e publikuara nuk shoqërohen me një licencë të posaçme për ripërdorimin, çdo person fizik apo juridik që përdor të dhënat e publikuara, ka detyrimin ligjor dhe etik, si dhe duhet të citojë qartë burimin e informacionit. Citimi i saktë i burimit është një praktikë që garanton transparencën, ruan integritetin e të dhënave dhe vlerëson kontributin e institucionit fond krijues, si krijues dhe shpërndarës i informacionit publik. Mospërmbushja e këtij detyrimi përbën shkelje të parimeve etike dhe të standardeve të përdorimit të informacionit publik. Për çdo rast përdorimi, riprodhimi apo përpunimi i të dhënave të publikuara nga Këshilli i Qarkut Shkodër, duhet të përdoret ky formulim:

“Burimi: Këshilli i Qarkut Shkodër – Open Data (Të dhëna të hapura), [data e publikimit ose linku]”.